



KOMUNIKATË PËR MEDIA

- **Tërheqet nga privatizimi Ndërmarrja e Re Ndërtesa e Administratës dhe Depo Sh.P.K.**

Prishtinë- Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) njofton se ka tërhequr nga tenderi për privatizim Ndërmarrja e Re Ndërtesa e Administratës dhe Depo Sh.P.K. Kjo ndërmarrje ishte paraparë të privatizohet me datë 29 mars 2012 përmes Valës 54 të privatizimit.

Lista e ndërmarrjeve që do të privatizohen përmes Valës 54 tani përmban 29 ndërmarrje të reja, dhe të gjitha këto Ndërmarrje të Reja do të privatizohen përmes Spin off-it të Rregullt.

Dita për dorëzimin e ofertave për asetet në vijim është 29 mars 2012, nga ora 10:00 deri në orën 12:00, kurse hapja e ofertave do të bëhet po të njëjtën ditë duke filluar nga ora 12:30.

Në vazhdim mund të gjeni të bashkangjitur listën e plotë të ndërmarrjeve të parapara për shitje përmes Valës 54 të privatizimit:

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Gjylekar Sh.P.K - Prona kryesore e kësaj Ndërmarrjeje të Re përbëhet nga toka bujqësore që gjendet në afërsi të fshatit Gjylekar, Komuna e Vitisë. Prona e përgjithshme që do t'i bartet Ndërmarrjes së Re ka një sipërfaqe të përafërt prej 37.8 ha (378232 m²).

Ndërmarrja e Re Sharr Depoja Materialit Ndërtimor Sh.P.K - Kjo ofertë ofron mundësi të shkëlqyeshme për të blerë tokë në sipërfaqe të përafërt prej 4000 m² të përshtatshme për zhvillim të çdo lloji të afarizmit, që ndodhet në periferi të qytetit të Ferizajt.

Ndërmarrja e Re KBK Strezoci Ndërtesa e Administratës dhe Oborri Sh.P.K - Kjo ofertë do të sigurojë një mundësi të shkëlqyer për të blerë ngastër toke në madhësi prej përafërsisht 2250 m² së bashku me ndërtesën me rreth 160 m² të përshtatshme si pikë për grumbullimin e produkteve të ndryshme bujqësore (qumështi, kërpudhat, etj) dhe vend për shitjen e sendeve të ndryshme bujqësore, të vendosura në fshatin Strezovc 12 km nga qyteti i Kamenicës.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Ndërmarrja e Re Lux Supermarket Ibër Sh.P.K - përbëhet nga prona e supermarketit dhe përfshinë një sipërfaqe prej gjithsej 514.06 m² me vendndodhje në rrugën Mbreti Agron (ish rruga e Mbretit Petër dhe Mareshalit Tito) në Mitrovicën Veriore, në afërsi të urës kryesore. Vetëshërbimi është i uzurpuar nga persona të panjohur. Nuk ka tokë për tu transferuar në këtë Ndërmarrja të Re.

Ndërmarrja e Re Jugobanka Zyra në Vushtrri/Vucitrn Sh.P.K. - Kjo shitje i mundëson blerësve potencial të blejnë hapësirat për zyre në një sipërfaqe prej 60 m² që gjenden në katin përdhës të ndërtesës së Komunes në qendër të Vushtrrisë, në rrugën Dëshmorët te Kombit, p.n. Banka Themelore "Jugobanka" është bërë pronare e lokalit sipas Kontratës së Shitblerjes nr. 1071 të datës 27.02.1972. Zyra është në përdorim nga Komuna e Vushtrrisë që nga viti 1999, pa pëlqimin e Menaxhmentit të Jugobankës dhe Komuna e Vushtrrisë nuk e njeh të drejtën pronësore të Jugobankës.

Ndërmarrja e Re Kopiliq i Poshtëm 1 Sh.P.K. - përbëhet prej tokës bujqësore, me lokacion në fshatin Kopiliq i Poshtëm, Komuna e Skenderajt, e cila përafërsisht përfshinë një sipërfaqe prej 125 ha 76 ari 68 m² (1, 257668 m²).

Ndërmarrja e Re Kopiliq i Epërm Sh.P.K. - përbëhet prej tokës bujqësore, me lokacion në fshatin Kopiliq i Epërm, Komuna e Skenderajt, e cila përafërsisht përfshinë një sipërfaqe prej 36 ha 11ari 10 m² (361110 m²).

Ndërmarrja e Re Gllavotin Sh.P.K - përbëhet prej tokës bujqësore, me lokacion në fshatin Gllavotin e regjistruar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr .UL-70202017-00064, Komuna e Vushtrrisë, përafërsisht përfshinë 10 ha 04 ari e 92 m² (100492 m²).

Ndërmarrja e Re Univerzal Depo në Leposaviq Sh.P.K. - ka gjithsej 7.583 m² nga toka pjesë e Ndërmarrjes së Re. Ka rreth 2.655 m² hapësirë të ndërtuar dhe të ndarë midis një depoje kryesore prej rreth 2.465 m², një ndërtesë administrative prej rreth 182 m² dhe një portë të sigurisë prej përafërsisht 8 m². Magazina është e ndarë në 4 sipërfaqe të barabarta e të pavarura magazinimi. Prona gjendet në Slanishte, Komuna e Leposaviqit. Aktualisht menaxhmenti i NSh nuk është i gatshëm të bashkëpunoj me AKP- RO në Mitrovicë, dhe për këtë arsye nuk ka të dhëna lidhur me gjendjen e pronës që do të ritenderohet në Valën e 54.

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Rracaj Sh.P.K. - përbëhet nga toka bujqësore me sipërfaqe rreth 108 ha 39 ari dhe 17 m² (1083917 m²) e



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

cila shtrihet në një kompleks në katër zona kadastrale, Rracaj, Kodra e hutit, Skivijan dhe Osek Hylë, në një largësi rreth 6 km nga qyteti i Gjakovës e që shtrihet në mes rrugëve Gjakovë-Pejë dhe asaj Gjakovë-Junik.

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Rastavicë D Sh.P.K. - përbëhet nga toka bujqësore me sipërfaqe rreth 7 ha 1 ari dhe 22 m² (70122 m²) që shtrihet në një kompleks në Zonën Kadastrale Rastavicë, Komuna e Deçanit që ndodhet rreth 1 km larg nga rruga rajonale Gjakovë - Pejë dhe afër rrugës për në Junik.

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Nepole Sh.P.K. - përbëhet nga toka bujqësore me sipërfaqe rreth 69 ha 79 ari dhe 63 m² (697963 m²) që ndodhet në ZK Gllogjan, Fshati Nepole, Komuna Pejë.

Ndërmarrja e Re Dukagjiniremont - Depo Sh.P.K - përbëhet nga depoja me sipërfaqe të përafërt 406 m² e cila ndodhet në katin përdhes të një ndërtese banimi afër stacionit të autobusëve në qytetin e Pejës.

Ndërmarrja e Re Dumnicë Tokë Bujqësore Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe prej përafërsisht 189,570 m² (18 ha 95 ari 70 m²) e cila gjendet në zonën kadastrale Dumnicë e Poshtme. Asnjë ndërtesë, gjedhe apo asete të lëvizshme nuk do të përfshihen në këtë tender.

Ndërmarrja e Re Përparimi Tokë Bujqësore Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe prej përafërsisht 88,045 m² (8 ha 80 are 45 m²) e cila gjendet në zonën kadastrale Merdare, ne Komunën e Podujevës. Asnjë ndërtesë, gjedhe apo asete të lëvizshme nuk do të përfshihen ne këtë tender.

Ndërmarrja e Re Rilindja Shitorja Mitrovicë Sh.P.K. - i ofron investitorit potencial një mundësi të fitoj lokalin afarist me sipërfaqe përafërsisht 68.48 m², e cila gjendet në qendër të Mitrovicës, që ofron mundësi të mira për aktivitete komerciale.

Ndërmarrja e Re Flora Tokë Bujqësore III Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe prej përafërsisht 30,344 m² (3 ha 3 ari 44 m²) e cila gjendet në zonën kadastrale Zakut. Asnjë ndërtesë, gjedhe apo asete të lëvizshme nuk do të përfshihen në këtë tender.

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Breznicë A Sh.P.K. - gjendet në zonën kadastrale Breznicë të komunës së Obiliqit, dhe zonën kadastrale Barilevë të komunës së Prishtinës dhe përbëhet kryesisht nga toka bujqësore. Ndër. e Re përbëhet prej përafërsisht 408,075 m²



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

(40 ha 80 ari 75 m²). Ky tender i ofron investitorit potencial mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm të agrobiznesit në rajonin e periferisë së komunës së Obiliqit.

Ndërmarrja e Re Rilindja Shitja Gjakovë Sh.P.K. - i ofron blerësve potencial mundësi për blerjen e lokalit afarist me një sipërfaqe prej përafërsisht 26.24 m² që gjendet në qendër të Gjakovës.

Ndërmarrja e Re Mulliri Tokë në Lipjan Sh.P.K. - ofron tokë urbane me sipërfaqe përafërsisht 2,146 m² (21 ari 36 m²) në një pjesë mjaft atraktive në Lipjan, afër Fabrikës "Bonita" dhe hekurudhës.

Ndërmarrja e Re Drita Shajkoc II Sh.P.K. - ofron tokë me sipërfaqe prej përafërsisht 44,729 m² (4 ha 47 ari 29 m²), në një pjesë mjaft atraktive në Shajkoc, në afërsi të liqenit të Batllavës.

Ndërmarrja e Re Shtime Tokë Bujqësore III Sh.P.K. - ofron tokë bujqësore me sipërfaqe përafërsisht 34,207 m² (3 ha 42 ari 7 m²) në një pjesë atraktive të Shtimes. Prodhimtaria e produkteve bujqësore mund të rritet dukshëm me investime përkatëse.

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Gllanasellë 1 Sh.P.K. - me rreth 504,106 m² (50 ha 41 ari 6 m²) tokë bujqësore. Ndër. e Re shtrihet në një kompleks të vetëm bujqësorë në zonën kadastrale Gllanasellë.

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Gllanasellë 2 Sh.P.K. - me rreth 381,519 m² (38 ha 15 ari 19 m²) tokë bujqësore. Ndër. e Re shtrihet në një kompleks të vetëm bujqësorë në zonën kadastrale Gllanasellë.

Ndërmarrja e Re Liria "Mini Shtëpia e Mallrave"-Terzimahallë Sh.P.K.
- Kompleksi komercial/Mini shtëpia e mallrave për tu bartur në Ndërmarrjen e Re sipas fletës poseduese dhe kopjes së planit të lëshuar nga ZKK-Prizren përshin një sipërfaqe totale të gabaritit prej 281 m². Kompleksi komercial/Mini shtëpia e mallrave përmban ndërtesën dykatëshe (B+P+1) që përfshin katin përdhës me sipërfaqe rreth 225 m² (dy shitore dhe një depo), katin e parë në sipërfaqe rreth 200 m² dhe bodrumi me sipërfaqe rreth 30 m². Sipërfaqet e prezantuara si më lartë janë sipas matjeve interne dhe jo zyrtare. Kompleksi komercial/Mini shtëpia e mallrave ndodhet në rrugën "I.J.Kumanova" p.n. në Terzimahallë, zonë primare e qytetit të Prizrenit. Aktualisht dy shitore që ndodhen në përdhës të kompleksit komercial/mini shtëpia e mallrave janë të dhënë me qira palëve të treta. Vërejtje: ndërtesa për banim trekatëshe e cila ndodhet përmbi objektin mini shtëpia e mallrave nuk është lëndë e këtij tenderi.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Ndërmarrja e Re Liria “Kompleksi komercial”-Lakuriq Sh.P.K. - përmban kompleksin komercial me sipërfaqe totale prej përafërsisht 485 m². Kompleksi komercial ndodhet në katin përdhes të ndërtesës shumëkatëshe afariste-banesore, në rrugë “Hadi Kantarxhiu” p.n. në Lakuriq, zone primare e qytetit të Prizrenit. Aktualisht kompleksi komercial (përveç dy zyrave që shfrytëzohen nga NSH-ja) është i dhënë me qira palëve të treta.

Ndërmarrja e Re Vreshtaria 1 – Tokë Bujqësore në Smaq Sh.P.K. - përfshin tokën bujqësore (vreshta jo aktiv) me sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 18 ha 35 ari 20 m² (183,520 m²). Ndërmarrja e Re ofron sipërfaqe të mjaftueshme tokësore të përshtatshme për prodhimin e rrushit si dhe kultivimin e drithërave të ndryshëm në shkallë industriale. Kushtet klimatike dhe toka i mundësojnë pronarit të ardhshëm të vazhdojë me kultivimin e rrushit.

Ndërmarrja e Re “Depo Zhur”- Prizren Sh.P.K - Ndër. e Re “Depo Zhur”- Prizren - përfshinë njësinë e NSH Prizrencoop ne fshatin Zhur Komuna e Prizrenit në ngastrën 2285-2 me sipërfaqe prej 390 m² dhe 2288-2 me sipërfaqe prej 340 m², (total 730 m²) në kuadër të së cilës objekti ka afërsisht 250 m² (objekti i paregjistruar ne elaboratin kadastral). Prona është e regjistruar në emër të KB Prizrencoop në Prizren sipas Certifikatës së pronësisë UL 71813026-00815 e datës 06/10/2011.

Ndërmarrja e Re “Depo Piranë”- Prizren Sh.P.K - Propozimi për Ndërmarrjen e re përfshin njësinë e NSH Prizrencoop ne fshatin Piranë Komuna e Prizrenit. Sipërfaqja e prezantuar në Certifikatën e pronësisë me numër UL 71813064-00508 në sipërfaqe prej 1138 m², parcela P 71813064- 01052-2, ZK Pirane është sipërfaqe e cila ofrohet për shitje. Prona e cila është lëndë e këtij tenderi përfshihet në ngastrën 1052-2 dhe atë me sipërfaqe prej 1138 m², tokë me kulturë kullosë. Në kuadër të ngastrës gjindet objekti i cili ka rreth 462 m², sipërfaqe kjo e shfrytëzuar n ga NSH-ja dhe e njëjta nuk është e regjistruar në emër të KB Prizrencoop në Prizren sipas Certifikatës së pronësisë UL 71813064-00508.

FUND

Arta Gosalci

Public Relations Officer

Privatisation Agency of Kosova

Phone:+381/038 500 400 extension:1110

Email. arta.gosalci@pak-ks.org

Rr. Ilir Konushevc No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevci No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org